

VENDIM
Nr.24, datë 19.1.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.140, DATË 17.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 2 shkronja “c” e 26 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 5 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Fjala e parë e pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Buxheti për shërbimet spitalore, për vitin 2011, jepet me hollësi, sipas shtojcës 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.
 - b) Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“17. Spitalet dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor janë të detyruara të llogarisin koston e çdo shërbimi, në përputhje me standardet e caktuara nga Ministria e Shëndetësisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2011.”.
 - c) Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“20. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve, për vitin 2011, të jetë i pandryshuar, krahasuar me vitin 2010.”.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha